

Fjala e Dr. Ezio Gianni Murzi, përfaqësues a.i. i UNICEF-it

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Të nderuar pjesëmarrës,

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson mbështetjen teknike të UNICEF-it për zbatimin e këtij memorandumi për mbrojtjen më të mirë të të drejtave të fëmijëve në procesin legjislativ dhe të kontrollit parlamentar.

Bashkëpunimi me UNICEF-in është i gjatë në Shqipëri, por bashkëpunimi me z. Xhani Muizi ndonëse ishte i shkurtër në kohë, ishte intensiv, konkret, produktiv dhe pozitiv.

Falë këtij komunikimi dhe qasje të bashkëpunimit tuaj në këto 4 muaj të punimeve të legjislativës së re të Kuvendit, rezultati i parë i bashkëpunimit institucional është nënshkrimi i këtij memorandumi.

Me lejoni t'ju falënderoj z. Xhani Muizi përfaqësues rezident i UNICEF-it në Shqipëri për kontributin e dhënë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri dhe mbështetjen e veprimtarive të Kuvendit në nismat që kanë të bëjnë me fëmijët

Do dëshiroja që bashkëpunimi me Ju personalisht të vazhdonte më gjatë.

Kauzat e mbrojtjes së fëmijëve kanë nevojë për kontributin e personaliteteve si z. Muizi.

Sot ne nënshkruajmë këtë memorandum bashkëpunimi mes nesh, por unë besoj dhe shpresoj se përfaqësuesi i ri rezident i UNICEF- në Tiranë do të vazhdojë bashkëpunimin me të njëjtin përkushtim sikurse edhe ju!

Me rastin e largimit të tij nga Shqipëria, Ju uroj jetë të gjatë, shëndet dhe qofshi aktiv në mbrojtje të fëmijëve.

Ju faleminderit!